



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, më 11.2.2020

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 11.2.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cani

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Pasi u njohëm me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat bashkëlidhur tyre, përcjellë me anë të shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga ana e Kolegjit, duke i analizuar ato në raport me secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha shkaqet e ankimit mbeten për t’u marrë në shqyrtim e për t’u gjykuar nga ana e këtij trupi gjykues, pasi konstatohet se:

### I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Për sa i përket shkaqeve të ankimit *për pasurinë nr. 1, “Apartament”, i ndodhur në rrugën “\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij<sup>1</sup>, ndër të tjera, ka prapësuar se:

- (i) Huaja në shumën 500.000 lekë është deklaruar në DV-2005, ndërsa në D-Vett., ajo pasqyrohet në zërin “*detyrimet familjare*” prej 1.000.000 lekë dhe në seksionin “*të dhëna konfidenciale*” përmenden personat ndaj të cilëve ka pasur detyrime financiare, ku rezulton edhe z.\*\*\*.\*\*\*.

<sup>1</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit, datë 20.1.2020, f. 20-39.

- (ii) Është i pabazur aludimi mbi pamundësinë ekonomike të baxhanakut, \*\*\*, \*\*\*, dhe familjes së tij, për të dhënë hua shumën 500.000 lekë. Në mbështetje të këtij prapësimi, subjekti ka dorëzuar si provë të re shkresën nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2019, të Drejtorisë së Shëndetit Publik Kavajë, për znj.\*\*\*.\*\*\*.
- (iii) Nuk ka asnjë paqartësi lidhur me marrëdhëniet e huas me z.\*\*\*.\*\*\* dhe z.\*\*\*.\*\*\*.
- (iv) Për shumën prej 50.000 lekësh, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është përdorur në një kohë të dytë për shlyerjen e këstit të parë, për blerjen e apartamentit.<sup>2</sup>
- (v) Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit në shumën 621.085 lekë<sup>3</sup>, subjekti ka prapësuar se kjo vjen si rezultat i mosmarrjes në konsideratë<sup>4</sup> të fakteve se: (a) në deklaratat vjetore të interesave pasurore për vitet 2003-2004, gabimisht nuk është deklaruar gjendja *cash* në banesë; (b) mosmarrja parasysh e standardit të jetesës në \*\*\*, si dhe (c) mungesa e koherencës në llogaritjen e këtij standardi jetese për vitet 2003-2006, ndërmjet ILDKPKI-së dhe KPK/IKP.

1.1 **Komisioneri Publik**, për sa më sipër, vlerëson se:

- 1.1.1 Lidhur me marrëdhëniet e huave (pikat “i-iii” më sipër), në shumat respektive 500.000 lekë dhe 350.000 lekë, theksojmë se në përllogaritjen financiare të pasqyruar në ankimin e datës 8.2.2019, i kemi marrë në konsideratë këto hua si burime të ligjshme në krijimin e pasurisë nr. 1, pavarësisht paqartësive dhe deklarimeve kontradiktore të subjektit mbi këto hua. Megjithatë, edhe në këtë eventualitet, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.
- 1.1.2 Lidhur me shumën prej 50.000 lekësh (pika “iv” më sipër), pretendimin e subjektit të rivlerësimit e gjejmë të pabazuar në prova, pasi nga rrethanat faktike është e pamundur që një shumë e depozituar dhe tërhequr pas pagesës së këstit të parë, të jetë përdorur për shlyerjen e këtij kësti.
- 1.1.3 Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën 621.085 lekë, për pagesën e këstit të parë të apartamentit (pika “v” më sipër), vlerësojmë se pretendimi i subjektit se ka pasur gjendje *cash* në banesë të padeklaruar gabimisht në deklaratat vjetore për vitet 2003-2004, është i pabazuar në prova dhe në ligjin e zbatueshëm. Për këtë vlerësim, bazohemi edhe në jurisprudencën e Kolegjit, i cili në vendimet (JR) me nr. 7/2019, nr. 11/2019 dhe nr. 29/2019, ka mbajtur qëndrimin se:

*[...] Për sa kohë që gjendja cash nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, nuk mund të prezumojmë përdorimin nga subjekti i rivlerësimit të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurisë [...];*

*[...] legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit. ... Për rrjedhojë, subjekti nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së këtij deklarimi [...];*

*[...] Në kushtet e mosdeklarimit të kursimit, konsiderohet që të gjitha të ardhurat e realizuara deri më 31.12...(të vitit të deklarimit) të jenë shpenzuar plotësisht [...].*

<sup>2</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit, datë 20.1.2020, f. 9, prg. 14.

<sup>3</sup> Kjo diferencë negative ka dalë nga analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik.

<sup>4</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit, datë 20.1.2020, f. 37.

1.1.4 Lidhur me pretendimin e subjektit, se për periudhën 2003-2006 shpenzimet e jetesës janë në shumën 438.228 lekë/vit për një familje me katër anëtarë<sup>5</sup>, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe nëse llogarisim shpenzimet e jetesës për familjen Cani sipas këtij pretendimi, përsëri subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit, në shumën - 484,665 lekë.

1.1.5 Përveç sa parashtruam, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë të re lidhur me pagesën e shumës 6.000 euro, shumë e cila sipas nenit 3<sup>6</sup>, të kontratës së sipërmarrjes të datës \*\*\*.9.2005, është paguar në datën \*\*\*.1.2006.

1.1.6 Si konkluzion, për pasurinë nr. 1, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën - 484,665 lekë, për pagesën e këstit të parë, dhe në shumën 6.000 euro, për pagesën e datës \*\*\*.1.2006. Si pasojë, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë, rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**2.** Për sa i përket shkaqeve të ankimit **për pasurinë nr. 2, “Truall” dhe një “banesë private”, në \*\*\* , Tiranë**, subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve të tij, ka paraqitur 9 prova të reja:

- (i) Shkresë nr.\*\*\*, datë \*\*\*.10.2019, nga ISSH-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror;
- (ii) Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, nga ISSH-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror, lidhur me vjetërsinë në punë të z. Besnik Cani për periudhën janar – shtator 1992;
- (iii) Kopje libreze pune për z.\*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1975-1980;
- (iv) Vërtetim page për z.\*\*\*.\*\*\*, datë \*\*\*.6.1991, për të ardhurat e periudhës 1987-1989;
- (v) Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë, lidhur me të ardhurat e z.\*\*\*.\*\*\* nga pensioni i pleqërisë për periudhën \*\*\*.2.1991 – \*\*\*.2.2019;
- (vi) Vërtetim nga ISSH-ja, datë \*\*\*.10.2019, pa numër prot., për vjetërsinë në punë të z.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*, për periudhën \*\*\*.10.1990 – \*\*\*.12.1991;
- (vii) Shkresë nr.\*\*\*, datë \*\*\*.3.2018, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Dibër, lidhur me të ardhurat e z.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1985-1991;
- (viii) Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2018, për trajtim me pagesë papunësie për periudhën \*\*\*.12.1991 – \*\*\*.12.1992, të z.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*;
- (ix) Shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2018, nga ISSH-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror, lidhur me pagën bruto të z.\*\*\*.\*\*\* për periudhën tetor 1993 – maj 1998.

**2.1 Komisioneri Publik**, në analizë të provave të mësipërme, vlerëson se të ardhurat që kërkon të provojë subjekti i rivlerësimit janë në shumën të vogla krahasuar me vlerën e investimit të deklaruar nga subjekti në DV-2003. Këto të ardhura i përkasin kryesisht periudhës para vitit 1992, dhe në referencë të vendimit (JR) nr. 14/2019 të Kolegjtit, ato [... janë të papërfillshme... Si rrjedhojë provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e realizuara para vitit 1992 kanë vlerë provuese të kufizuar në kontekstin e rivlerësimit].

**2.2** Si konkluzion, për pasurinë nr. 2, rezulton se edhe me provat e reja të paraqitura nga subjekti, nuk provohet plotësisht burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie.

**3.** Për sa i përket shkaqeve të ankimit **për analizën financiare për vitet 2010-2015**, si shkak ankimi kemi ngritur se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme, shpenzimet dhe investimet e kryera gjatë këtyre viteve, për një diferencë totale negative prej - 2.152.963 lekësh.

<sup>5</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit, datë 20.1.2020, f. 35, prg. 42.

<sup>6</sup> Sipas këtij neni, parashikohet se shumën prej 46.000 euro do të paguhet në datën \*\*\*.1.2006, nga të cilat 40.000 euro janë marrë kredi nga \*\*\* Bank në janar 2006.

3.1 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të datës 20.1.2020<sup>7</sup>, ndër të tjera, për këtë shkak ankimi, ka parashtruar se:

3.1.1 Nuk janë marrë në konsideratë: (i) ndarja e shpenzimeve me një koleg, për udhëtimet Tiranë – Fier; (ii) dietat dhe honoraret e përfituara si anëtar i Këshillit të Prokurorisë; (iii) shpenzimet e udhëtimeve për punë, të mbuluara nga institucionet; (iv) deklaratat noteriale sa i përket shpenzimeve spitalore të bashkëshortes; (v) bonuset e karburantit, si dhe (vi) ka pretenduar për pasaktësi në llogaritje.

3.1.2 Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 8 prova të reja:

- (i) Urdhër nr.\*\*\*, datë \*\*\*.10.2010, nga Prokuroria e Përgjithshme, për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë;
- (ii) Urdhër shpenzimi nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2010, nga Prokuroria e Përgjithshme;
- (iii) Listëpagesë e Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën 1– 31 dhjetor 2010;
- (iv) Bordero për shpërblim të anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë;
- (v) Urdhër nr.\*\*\*, datë \*\*\*.3.2010, nga Prokuroria e Përgjithshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë;
- (vi) Urdhër shpenzimi nr.\*\*\*, datë \*\*\*.4.2010, nga Prokuroria e Përgjithshme;
- (vii) Listëpagesë e punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme;
- (viii) Bordero për shpërblim të anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë për muajin prill 2010.

3.2 **Komisioneri Publik**, në analizë të këtyre provave, vlerëson se:

3.2.1 Shumat 31.500<sup>8</sup> lekë dhe 36.000<sup>9</sup> lekë janë honorare të përfituara nga subjekti për pjesëmarrje në Këshillin e Prokurorisë. Në këto kushte, këto shuma, në total prej 67.500 lekë, janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2010.

3.2.2 Për sa i përket pretendimit të subjektit, për të përfshirë në zërin e të ardhurave edhe dietat, vlerësojmë se ky pretendim nuk qëndron, pasi në referencë të vendimit orientues të Kolegjit (JR), nr. 7/2019 [*... të ardhurat e përfituara në formën e dietës janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura...*].

3.2.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi shpenzimet e udhëtimit, Komisioneri Publik sqaron se, ashtu sikundër është theksuar edhe në përlllogaritjet e paraqitura në ankim, janë llogaritur si shpenzime në analizën financiare për periudhën 2010 – 2015 vetëm ato shpenzime që lidhen me udhëtimet personale, të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij. Udhëtimet e punës, të vërtetuara me shkresë nga institucionet përkatëse, nuk janë konsideruar si shpenzime të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

3.2.4 Për sa i përket pretendimit të subjektit për të përfshirë në zërin të ardhura: (i) kontributet financiare nga të afërm/miq (për shpenzimet spitalore të bashkëshortes znj.\*\*\*.\*\*\*) dhe (ii) ndarjen e shpenzimeve të udhëtimit Tiranë – Fier me një koleg, ritheksojmë qëndrimin tonë, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>10</sup>, se deklaratat noteriale që datojnë pas D-Vett. merren me rezervë për fuqinë e tyre provuese, nëse ato, në kuptim të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, nuk janë në harmoni dhe në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera.

3.2.5 Për sa i përket pretendimit të subjektit, mbi pasaktësi në llogaritjen e likuiditeteve në bankë, pagave dhe shpenzimeve të udhëtimit (referuar f. 49-53 të parashtrimeve), konstatojmë se këto pretendime lidhen me analizën financiare të kryer nga Komisioni. Theksojmë se këto pretendime

<sup>7</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit (f. 45-54).

<sup>8</sup> Pasqyruar në provat e listuara në pikat “v-viii”.

<sup>9</sup> Pasqyruar në provat e listuara në pikat “i-iv”.

<sup>10</sup> Për më tepër, në këtë drejtim, referohuni në vendimin (JR) nr. 10/2018.

të ngritura edhe më parë nga subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit<sup>11</sup> janë pasqyruar në përlogaritjet financiare të Komisionerit Publik, paraqitur në ankimin e datës 8.2.2019.

3.2.6 Si konkluzion, për analizën financiare për vitet 2010 – 2015, nga vlerësimi i provave të dorëzuara nga subjekti, u morën në konsideratë të ardhurat në shumën 67.500 lekë, për vitin 2010, dhe, në përfundim, subjekti rezultoi me një diferencë totale negative në shumën – 2.085.463 lekë.

## II. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale (etika, figura)

### (i) Marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë “\*\*\*\*” SHPK

4. Lidhur me shkaqet e ankimit të ngritura për marrëdhënien juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me shoqërinë “\*\*\*\*” SHPK, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova të reja në prapësimet e tij. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në interpretimin përkatës, u qëndron të njëjtave argumenteve ligjore të parashtruara edhe para Komisionit, duke parashtruar se marrëdhënia juridike-civile është konceptuar nga ai në kuadrin e një marrëdhënie qiraje, ku ekzistojnë dy palë (qiramarrësi dhe qiradhënësi), ku ekziston një send që jepet me qira, ku shpërblimi është i caktuar/variabël, duke pretenduar kështu se nuk ka elemente që të vërë në dyshim apo të provojë si situatë konflikti interesi, trajtim preferencial, papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit, cenim të etikës dhe të figurës së magjistratit. Për këtë qëllim, subjekti, ndër të tjera, referon disa herë dhe kontrollin e ILDKPKI-së mbi këtë marrëdhënie kontraktuale, si institucioni i vetëm kompetent për konstatimin e konfliktit të interesit në Republikën e Shqipërisë.

4.1 **Komisioneri Publik** çmon se në një këndvështrim interpretativ të fakteve në raport me ligjin, në optikën e vlerësimit nga një person i arsyeshëm dhe i informuar<sup>12</sup>, mbi rrethanat konkrete në tërësi dhe të elementeve kontraktuale në veçanti të kësaj marrëdhënie interesi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të shpjegojë bindshëm të kundërtën. Konstatojmë se vetëm kontrata e nënshkruar prej tij, në krahasim me kontratat e tjera të ngjashme të administruara, ka elemente përmbajtësore të ndryshme, të cilat, ndër të tjera, provojnë se vetëm pas dy muajsh shoqëria qiramarrëse heq dorë nga përdorimi 25-vjeçar dhe marrjes së fitimit financiar të lavazhit dhe lokalit bar-kafe, të ndërtuar nga kjo e fundit me investimet e veta dhe, pa asnjë kompensim financiar, ia kalon këto të drejta subjektit të rivlerësimit.

4.2 Në vështrim të sa më sipër, kërkojmë nga Kolegji që vlerësimi i këtij shkak ankimi të analizohet në raport me kuadrin ligjor në fuqi, si neni 149/ç, i Kushtetutës, nenet 4, 7 e në vijim i ligjit nr. 96/2016, si dhe urdhrin nr. 141/2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, në fuqi para se ligji nr. 96/2016 të fillonte efektet e tij.

4.3 Duke përfunduar, duke i qëndruar këtij shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhënia kontraktuale e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” SHPK bie ndesh me detyrimet ligjore për magjistratin, të tilla që mjaftojnë për t’u vlerësuar si rrethana papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit për rastin konkret.

<sup>11</sup> Referohuni shpjegimeve të subjektit datë 20.11.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Në këtë drejtim, referohuni në “Komentarin mbi Parimet e Bangalore”, sjelljes së gjyqësorit, i cili aplikohet *mutatis mutandis* për prokurorët.

(ii) **Etika (përfitimi i statusit të pastrehë)**

5. Lidhur me shkaqet e ankimit të ngritura për çështjen penale nr.\*\*\*, viti 2012, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë nga subjekti, (sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.3.2013), konstatohet se subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij nuk ka paraqitur asnjë provë të re.

5.1 **Komisioneri Publik vlerëson se** subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë të kundërtën e situatës faktike, ku rezulton se, gjatë kohës kur ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ndërkohë që kjo prokurori kishte filluar një procedim penal mbi praktikën e pretenduar të paligjshme të ndjekura nga strukturat e Bashkisë Fier për kreditë e buta (2012 – 2014), familja e subjektit shpallet e kualifikuar me statusin “e pastrehë” (mars 2013) nga kjo Bashki, duke u konsideruar në këtë mënyrë subjekt i përfitimit të kredisë së butë nga shteti, në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

5.2 Për sa më sipër, duke analizuar natyrën e listës së dokumenteve ligjore që duhej të dorëzoheshin me qëllim përfitimin e statusit “të pastrehë”<sup>13</sup>, pretendimi i subjektit se nuk ka pasur dijeni për kryerjen e këtyre procedurave nuk është i bazuar.

(iii) **Lidhur me dy çështjet penale** (nr.\*\*\*/2006, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me nr.\*\*\*/2015, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan)

6. Për sa i përket prapësimet të subjektit të rivlerësimit, ku, ndër të tjera, për shkaqet e paraqitura në ankim, përfshirë dy çështjet penale, ajo me nr.\*\*\*/2006<sup>14</sup>, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me nr.\*\*\*/2015<sup>15</sup>, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkon që vlerësimi të kryhet sipas metodologjisë alternative, përcaktuar në vendimin (JR) nr. 21/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioneri Publik nënvizon argumentimin e Kolegjit në vendimin e mësipërm, ku arsyetohet se vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale [*... kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm, dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm*]. Kjo metodologji e natyrës alternative, sipas vendimit orientues, gjen zbatim [...] kur është e mundur dhe e nevojshme [...], duke përfshirë në këtë vlerësim edhe denoncimin e fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016.

6.1 Nisur nga ky qëndrim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, zbatimi i kësaj metodologjie alternative vlerësimi, bazuar vetëm në këto dy çështje penale, do të ishte e pamundur. **Komisioneri Publik thekson se** vlerësimin e dy çështjeve penale të lartpërmendura i ka bërë pjesë të shkaqeve të ankimit, pasi konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta në raport me vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në referencë të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Mangësitë e vërejtura nga vetë Komisioni, përfshirë këtu edhe dy çështjet e lidhura me etikën e

<sup>13</sup> Për më tepër, referohuni në kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 29.8.2012, në fuqi kur është miratuar vendimi i Këshillit Bashkiak Fier, me nr. 14/2013.

<sup>14</sup> Çështje e administruar dhe e vlerësuar në kuadër të denoncimeve nga publiku, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>15</sup> Kjo çështje është përzgjedhur me short, nga 5, sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

subjektit, të trajtuara më lart në këtë parashtrim, janë të tilla që nuk i përgjigjen përfundimit që ka arritur Komisioni, për t'ia transferuar organit inspektues disiplinor.

7. Duke përfunduar, ritheksojmë se të katër këto çështje, që lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, janë të njëjtat për të cilat Komisioni ka vendosur transferimin e tyre organit kompetent, për inspektimin e mundshëm të shkeljeve disiplinore, duke i nxjerrë jashtë juridiksionit të procesit të rivlerësimit, shkak për të cilin Komisioneri Publik, bazuar edhe në rekomandimin e Komisionit prej tre vëzhguesve ndërkombëtarë të ONM-së, i ka bërë pjesë të ankimit, duke i kërkuar Kolegjit që, bazuar në nenin 66, të ligjit nr. 84/2016, t'i marrë në shqyrtim dhe të shprehet mbi to.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**